

JANAR, 2024

RAPORTI MUJOR

METODOLOGJIA

[Iniciativa e Re Sociale](#) po kryen monitorimin e mediave online dhe mediave sociale në bashkëpunim me [Pikasa Analytics INC](#), një kompani e analitikës së të dhënave e specializuar në zhvillimin dhe zbatimin e mjeteve, softuerëve dhe algoritmeve të mësimit të makinerive. Mjeti i lejon monitoruesit të numërojnë numrin nominal të artikujve për tema të caktuara dhe të shohin nivelin e angazhimit të audiencës.

Angazhimet në uebsajte përcaktohen si artikuj të lajmeve që janë shpërndarë në Facebook nga uebsajti i çdo burimi dhe numri total i pëlqimeve, shpërndarjeve dhe komenteve që janë grumbulluar. Angazhimet në mediat sociale përfshijnë pëlqimet, shpërndarjet dhe komentet e mbledhura nga të gjitha kanalet e mediave sociale (Facebook, Instagram, YouTube, TikTok, LinkedIn) për të gjitha postimet, duke përfshirë fotot, videot dhe tekstin. Vlerësimi i angazhimit shtrihet përtej organeve të mediave për të përfshirë një sërë llogarish të mediave sociale përfshirë ato të politikanëve dhe opinionbërësve.

Mjeti grumbullon artikuj dhe ekipi monitorues i NSI-së i shqyrton ato për të identifikuar dezinformimin e mundshëm dhe çrregullimet tjera informative. Megjithatë, metodologjia ka disa kufizime dhe është krijuar për të ngushtuar objektivin e monitorimit. Është përshtatur, ku çdo llogari e vëzhguar është zgjedhur me kujdes nga monitoruesit e Pikasa dhe NSI-së. Rrjedhimisht, numri i përgjithshëm i postimeve dhe artikujve përfshin vetëm llogaritë e vëzhguara, duke përjashtuar llogaritë e tjera që gjithashtu mund të postojnë lajme. Megjithatë, llogaritja e angazhimit përfshin të gjitha shpërndarjet, komentet dhe ndërveprimet e tjera.

Për më tepër, nuk mund të vëzhgohen llogaritë private. Mund të vëzhgohen vetëm llogaritë e përcaktuara zyrtarisht të liderëve politikë ose faqeve të fansave. Për rrjedhojë, disa llogari të politikanëve në Facebook mund të mos përfshihen në analizë. Një kufizim tjetër lidhet me qasjen, pasi NSI mund të vëzhgojë artikuj dhe postime të publikuara që në 1 dhjetor 2023.

Mediat e vëzhguara që raportojnë nga Kosova në gjuhën serbe

Alternativna, Gračanica online, Radio Kontakt Plus, Kosovo Online, KoSSev, Medija Centar, TV Most, Radio Kim, Radio Mitrovica Sever, Radio Televizija Gračanica, and RTK2

Periudha e vëzhgimit:

January 1 – January 31

Numri i mediave online të vëzhguara:

126 media që raportojnë në shqip dhe serbisht në Kosovë, 126 media nga Serbia dhe 24 media ndërkombëtare.

Qëllimi i monitorimit:

Çrregullimet informative në internet dhe uebsajtet e mediave sociale, portalet e lajmeve online, Facebook, YouTube, TikTok dhe Instagram në Kosovë me fokus në hapësirën informative të serbëve të Kosovës.

Temat specifike të vëzhguara:

Zhvillimet në veri të Kosovës (rreth 600 artikuj nga mediat në Kosovë të shqyrtuara dhe rreth 1000 artikuj nga mediat në Serbi), ndalimi i dinarit (rreth 400 artikuj nga mediat në Serbi të vëzhguara dhe 300 artikuj nga mediat në Kosovë), liberalizimi i vizave (rreth 600 artikuj nga mediat në Kosovë)

Informata të përgjithshme në lidhje me temat e vëzhgimit:

Në janar të vitit 2024, 8 vjet pasi Kosova i përmbushi kushtet teknike dhe gjashtë vjet pas përmbushjes së kushteve kryesore politike, liberalizimi i vizave me BE-në u zbatua për shtetasit e Kosovës. Lëvizja e BE-së u pasua nga vende të tjera të botës, duke rritur vlerën e pasaportës së Kosovës. Politika ishte e shumëpritur dhe më se e mirëpritur në Kosovë dhe ka të ngjarë të mbetet një nga ngjarjet më të rëndësishme të vitit. Ndonëse ndodhi në dhjetor, në media ishte prezente edhe një masë tjetër që ndikoi pozitivisht në lirinë e lëvizjes – heqja e regjimit të stikersave për targat RKS që udhëtojnë nëpër Serbi dhe më pas heqja e stikersave për veturat serbe në Kosovë.

Një tjetër ngjarje e spikatur në media ishte njoftimi për fillimin e funksionimit të Elektroseverit dhe matjes dhe faturimit të shpenzimeve të energjisë elektrike në veri. Megjithatë, pavarësisht njoftimit, faturimi nuk ka filluar në janar.

Gjetjet kryesore

- Artikujt në lidhje me peticionin për tërheqjen e kryetarëve të komunave ishin përmbajtja më tërheqëse për mediat në Kosovë që raportonin në gjuhën serbe ndërsa notimi për në Kryqin e Shenjtë ishte tema më e popullarizuar në mesin e postimeve në mediat sociale. Ndërsa artikujt për liberalizimin e vizave shënuan muajin në mediat në Kosovë qëraportojnë në gjuhën shqipe.
- Tema mbizotëruese në lidhje me dezinformimin/keqinformimin në mediat në Kosovë që raportojnë në gjuhën shqipe ka të bëjë me largimin masiv të supozuar të kosovarëve pas liberalizimit të vizave, duke grumbulluar 819 angazhime. Për më tepër, media të ndryshme transmetuan informacione të marra nga portali B92 në Serbi, i cili interpretoi në mënyrë të pasaktë vërejtjet e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në lidhje me përfshirjen amerikane në incidentin me bombë në Mitrovicën e Veriut. Ky narrativ i veçantë mblodhi gjithsej 318 angazhime.

- Natyrë e dezinformatave të vëzhguara gjatë muajit në mediat në Serbi ishte kryesisht qëndrimi i rremë i BE-së dhe Bankës Qendrore Evropiane për rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës lidhur me operacionet me para të gatshme dhe pretendimet e rreme se pjesëtarët e FSK-së do të shkonin të luftonin në Ukrainë.


Rezultatet e monitorimit të mediave në Kosovë

Gjatë periudhës raportuese, media më aktive ishte Kosovo Online, e cila ka publikuar 2,921 artikuj me 33,256 angazhime. Megjithatë, uebsajti që regjistroi më së shumti angazhime ishte KoSSev, me 58,476 angazhime, pavarësisht se ishte media e katërt më produktive në gjuhën serbe në Kosovë, me vetëm 652 artikuj të publikuar në janar.

Në lidhje me mediat në Kosovë që raportojnë në gjuhën serbe, peticioni për të tërhequr kryetarët e komunave veriore ishte një nga temat më të spikatura të mbuluara në janar. Tri nga pesë temat me angazhimin më të madh të audiencës në faqet e mediave që raportojnë në gjuhën serbe kishin të bënin me nënshkrimin e peticioneve për votim për tërheqjen e kryetarëve të komunave. Dy grupe artikujsh raportuan për mbledhjen e nënshkrimeve në Mitrovicën e Veriut, dhe i treti raportoi për mbledhjen e nënshkrimeve në Zveçan.

Njëkohësisht, kjo ishte tema me numrin më të madh të artikujve të botuar në gjuhën serbe në Kosovë, me gjithsej 108 artikuj.


Temat popullore dhe angazhimi në uebsajt e mediave (20 më të mirat) që raportojnë në gjuhën serbe nga Kosova



1 Shtirja dhe toni i mbulimit të peticionit për shkarkimin e kryetarëve të komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës ishte objekt i një raporti të specializuar që mund të gjendet këtu.


Një artikull² i vetëm nga KoSSev, i cili raporton në gjuhën serbe, kishte më shumë se 400 angazhime, të cilat në kuadër të temës së dinarit, kishin parametrat më të lartë të angazhimit në krahasim me artikujt në gjuhën shqipe.

Angazhimi i lexuesve përmes llogarive të Facebook-ut të raportimit mediatik në gjuhën serbe




Kur është fjala mediat në Kosovë që raportojnë në gjuhën shqipe janari ishte muaji i shënuar nga liberalizimi i vizave. Grupi i artikujve me më së shumti angazhime mediatike lidhej me fluturimin e parë nga Prishtina më 1 janar. Vetëm më 1 janar, duke përfshirë edhe ato deri vonë më 31 dhjetor, janë publikuar 342 artikuj për liberalizimin e vizave. Po ashtu, më 21 dhe 22 janar janë publikuar 362 artikuj për takimin e liderëve të Ballkanit Perëndimor në Shkup. Për sa i përket dezinformimit/keqinformimit në lidhje me këtë temë, dy artikuj nxorën një total të kombinuar prej 819 angazhimeve.

Temat popullore dhe angazhimi në uebsajt e mediave (20 më të mirat) që raportojnë në gjuhën shqipe nga Kosova



² <https://kossev.info/dinari-sa-bankomata-i-saltera-od-februara-u-slamaricu-evro-jedina-valuta/>

Dezinformimi nëpër mediat me bazë në Kosovë që raportojnë në gjuhën shqipe




Tema mbizotëruese në lidhje me dezinformimin/keqinformimin në mediat në Kosovë që raportojnë në gjuhën shqipe ka të bëjë me largimin masiv të supozuar të kosovarëve pas liberalizimit të vizave, duke grumbulluar 819 angazhime. Për më tepër, media të ndryshme transmetuan informacione të marra nga portali B92 në Serbi, i cili interpretoi në mënyrë të pasaktë vërejtjet e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në lidhje me përfshirjen amerikane në incidentin me bombë në Mitrovicën e Veriut. Ky narrativ i veçantë mblodhi gjithsej 318 angazhime.

Media më aktive që raportoi në gjuhën shqipe nga Kosova ishte Beta Sot, e cila publikuar 12,995 artikuj me 102,867 angazhime. Megjithatë, uebsajti që regjistroi më së shumti angazhime në media sociale ishte Klan Kosova, me 357,978 angazhime, pavarësisht se ishte media e katërt më aktive në gjuhën shqipe në Kosovë, me vetëm 5,888 artikuj të publikuar në janar.

Në mediat në Kosovë që raportojnë në gjuhën shqipe, ngjarjet në Kosovën veriore shpesh raportohen përmes gjysmë informacionit, pa përcjellje në rastet kur informacioni fillestar është sqaruar ose hetimi është në vazhdim. Të tillë janë shembujt e bastisjeve të policisë në vende të ndryshme. Për shembull, duke cituar kreun e Rajonit të Policisë në Veri, media të shumta raportuan se në fund të janarit po bastisej një depo me produkte medicinale pa origjinë. Megjithatë, vetëm një pjesë e vogël e mediave e ndoqën lajmin pas bastisjes për të sqaruar se nuk u gjet asnjë produkt medicinal, por orendi që i përkisnin spitalit dhe nuk ishte bërë asnjë sekuestrim pasi malli ishte i regjistruar. Po ashtu, bastisjet e dy lokacioneve në Zveçan, ku thasët me rërë dyshohet se përdorshin për të forcuar barrikatadat, u raportuan si çështje të kryera.³

³ <https://indexonline.net/policia-bastise-edhe-nje-lokacion-ne-zvecan-gjenden-thase-te-rere-barrikadues-pamje/dhe> <https://www.gazetaexpress.com/pamje-te-thaseve-te-ribushura-me-rere-qe-uc-gjaten-nga-policia-e-kosoves-ne-zvecan-perdoreshin-ner-barrikatad/>

Këto media nuk raportuan saktë lidhur me bastisjen, duke prezumuar rreth pafajësisë dhe duke cituar supozimin e policisë për përdorimin e supozuar të gjësendeve të gjetura.



Të paktën pesë media në Kosovë që raportojnë në gjuhën shqipe ranë pre e dezinformimit nga B92 në Serbi dhe ndanë artikullin e tyre, i cili pretendonte se Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, fajësoi amerikanët për një sulm me bombë në Mitrovicën e Veriut. Kur tha, “Shpresoj që amerikanët të mos qëndrojnë pas kësaj”, Vuçiq kishte parasysh rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës që, e kombinuar me mbylljen e bankës Komerciale NLB, e bëri të pamundur importimin e dinarit serb në Kosovë.

Përpjekjet e vazhdueshme për të demantuar informacionet e rreme në tabloidet serbe nga mediat në Kosovë që raportojnë në gjuhën serbe kanë sjellë sukses të dukshëm⁴. Tabloidi serb Alo ka publikuar një artikull ku pretendon se Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani “ka krijuar kaos në Prishtinë dhe ia ka kthyer shpinën Kurtit” duke pohuar se pjesëmarrja në peticione është e drejtë qytetare. Artikulli origjinal i Alo nuk mat asnjë angazhim, ndërsa demantimi nga KoSSev ka shënuar 85 angazhime.

Dukagjini⁸ ka publikuar një deklaratë zyrtare nga Doganat e Serbisë, e vërtetuar me foto prova me pretendimin në titull se informacioni në vijim është “propagandë serbe” për të diskredituar lajmin për tentativë për kontrabandë armësh nga dy shtetas të Kosovës.



4 <https://gazetablic.com/vuciqi-ger-shperthimin-ne-veri-shpresoj-te-mos-jene-amerikanet-prapa-tij/> (21 angazhime), <https://www.botaonline.com/veprimet/214277/vuciqi-ger-shperthimin-ne-veri-shpresoj-te-mos-jene-amerikanet-prapa-tij/> (36 angazhime) dhe <https://sinjali.com/vuciqi-ger-shperthimin-ne-veri-shpresoj-te-mos-jene-amerikanet-prapa-tij/> (angazhim i ulët)

5 https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2024&mm=01&dd=16&nav_catagory=11&nav_id=2486332

6 <https://kosesev.info/ko-je-ta-osmani-napravila-haos-u-pristini-i-okrenula-ledja-kurtiju-prema-beogradskom-tabloidu/>


7 <https://www.alo.rs/vesti/kim/857470/haos-u-pristini-vjosa-okrenula-ledja-kurtiju-pratsednjica-lajme-drzave-nema-nista-pravtu-smene-gradonacelnika-na-severu/vesi-fbcid=twAR2dn36Rf3lNovv0T1V0Vyy4tCK4Kqj8e7g5D4eVVEFDstEHzfjU>

8 <https://www.dukagjini.com/propaganda-serbe-serbia-thote-se-ka-zbuluar-arsenal-armesh-ne-nje-makine-me-targa-rks/>

Sa i përket temës më të njohur në rrjetet sociale – liberalizimit të vizave, çrregullimet informative janë fokusuar kryesisht në raportime të bujshme që mund të shkaktonin panik me pretendime të tilla si “qytetarët po ikin”. Dy artikuj që përmbajnë një frazë të tillë të veçantë kanë shënuar 819 angazhime. Kishte një largim të pritur të madh të udhëtarëve nga Kosova në

janar, kryesisht për shkak të përfundimit të sezonit të festave dhe largimit të diasporës. Është sfiduese të dallohet nëse lajmi në fjalë përbën dezinformim apo keqinformim. Gjithashtu, zbatimi i liberalizimit të vizave është përdorur nga disa media në mënyrë manipulative për të sugjeruar që të gjithë udhëtarët jashtë Kosovës janë vërtet qytetarë që po emigrojnë. Kuptohet, një rritje e emigrimit për shkak të liberalizimit të vizave pritet dhe paralajmërohet nga shoqatat profesionale dhe ekspertët tjerë. Megjithatë, ky efekt do të jetë i arritshëm vetëm në muajt e ardhshëm. Lajmi ishte mjaft i përhapur sa që Ministria e Punëve të Brendshme duhej të lëshonte një deklaratë duke e mohuar këtë dhe demantimi shkaktoi një angazhim të lartë.

Ndonëse në vetvete nuk janë çrregullime informative, janë vërejtur disa artikuj që tregojnë për mungesën e vëmendjes së gazetarëve që nuk bëjnë pyetjet e duhura apo pasuese, duke i lejuar kështu politikanët të përhapin narrativa që nuk janë të sakta lehtësisht. Për shembull, një deputet i Kosovës, Haki Abazi,⁹ ka pohuar se Serbia i dha fund regjimit të stikersave me Kosovën për të përfituar nga pagesa e tarifave rrugore dhe taksave që makinat dhe autobusët do të duhej të paguanin gjatë lëvizjes nëpër Serbi pas liberalizimit të vizave. Përderisa trafiku nga Kosova përmes Serbisë do të rritej pas liberalizimit të vizave, kjo rritje nuk do të përkthehej në fitime të konsiderueshme për Serbinë dhe as vëllimi i automjeteve që kalojnë nëpër Serbi nuk do të ishte ndryshe nëse regjimi i stikersave do të ishte në fuqi. Përveç kësaj, njohja e targave të veturave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është rënë dakord në shkurt të vitit 2023.




⁹ <https://www.dukagjini.com/abazi-serbia-pranoi-targat-rks-per-te-perfituar-financiarisht-nga-levizja-e-qytetarëve-pas-liberalizimit-te-vizave/>

Raportimi i përgjithshëm për zhvillimet në veri të Kosovës ka qenë i ndarë mes deklaratave të zyrtarëve lokalë dhe të qeverisë, siç janë kryetarët e komunave apo zëvendësministrat, për pranimin e gjerë të strukturave të reja lokale nga qytetarët që dyshohet se ndihen të çliruar nga strukturat kriminale të udhëhequra nga Lista Srpska dhe deklaratat nga zyrtarët apo analistët e nivelit më të lartë, të cilët theksojnë rrezikun e vazhdueshëm të luftës me Serbinë dhe armatosjen e Kosovës nga SHBA-të si reflektim i potencialit të përshkallëzimit në veri të Kosovës.


Për sa i përket politikanëve dhe angazhimeve që kanë të bëjnë me deklaratat e tyre si në artikujt e shpërndarë ashtu edhe në postimet në rrjetet sociale (duke mos përfshirë X) të llojit tjetër, më së shumti angazhime në llogaritë që komunikojnë në gjuhën serbe janë shfaqur lidhur me Vjosa Osmanin pasuar nga Igor Simiç dhe Dalibor Jevtiç, me Albin Kurtin që është i katërti.

Politikanët e Kosovës në mediat serbe dhe postimet në rrjetet sociale




Rezultatet e monitorimit të mediave në Serbi

Dezinformimi nëpër mediat me bazë në Serbi



Tema mbizotëruese në sferën e dezinformative në mediat në Serbi përqendrohej në deklaratën e supozuar të Bankës Qendrore Evropiane në lidhje me paligjshmërinë e euros në Kosovë. Në lidhje me këtë, dezinformimi në lidhje me ushtarët e FSK-së që janë bindur nga Britania për t'u angazhuar në konflikt në Ukrainë gjithashtu ka tërhequr vëmendjen e konsiderueshme. Për më tepër, një seri artikujsh shfaqnin përdorimin e gjuhës nënçmuese dhe propagandonin gjuhën e urrejtjes drejtuar shqiptarëve të Kosovës.




Ndalimi i dinarit ishte një temë që përfshinte një sasi të konsiderueshme të manipulimit të informacionit. Manipulimet më serioze ishin titujt që i shtynë lexuesit të besojnë se Banka Qendrore Evropiane¹⁰ kishte publikuar një deklaratë për (pa)ligjshmërinë e përdorimit të euros në Kosovë.



Disa media kanë qasje në një njoftim të vjetër në uebsajtin e BQE-së dhe e kanë ndarë atë si një reagim të ri, i përshtatur në mënyrë të veçantë për të adresuar vendimin e Bankës Qendrore të Kosovës për të ndaluar dinarin nga transaksionet me para të gatshme në Kosovë.

¹⁰ <https://www.blic.rs/biznis/otvorenje/evro-nije-legalno-sredstvo-placanja-na-kosovu/578942a> <https://www.balkaninsights.info/evropska-unija-trazi-pojasnjenje-od-pristine-evro-nije-legalno-sredstvo-placanja-na-kosovu-i-metohiji/>, <https://www.kurir.rs/vesti/politika/4342012/evro-na-kosovu-nije-zakonsko-sredstvo-placanja> (4 artikuj, 90 angazhime)

Shembulli më i dukshëm i dezinformimit në tema të tjera ishte pretendimi i disa mediave në Serbi se pjesëtarët e Forcave të Sigurisë së Kosovës,¹¹ të cilët janë nisur për në Mbretërinë e Bashkuar për të marrë pjesë në trajnime ushtarake së bashku me ushtarët ukrainas, përfundimisht do të dërgohen në fushëbetejë në Ukrainë. “Ata do të jenë mish për top! Britanikët po dërgojnë shqiptarët e Kosovës në Ukrainë” është një nga titujt më grafik.




Fjalë fyese¹² për shqiptarët e Kosovës u përdorën në të paktën tre artikuj që trajtonin temën e ndalimit të dinarit, por gjithashtu u përdor një shkrim fonetik përçmues¹³ i fjalës “gjenocid” në shqiptimin në shqip.

“Terrori” dhe “plani djallëzor” i Kurtit janë përdorur për të përshkruar planet për ndalimin e dinarit, por edhe pretendimet se “gjermanët ia kanë ngrehur veshët Kurtit” ose se “Departamenti i Shtetit i ka dhënë një goditje Kurtit” u përdorën për të përshkruar deklaratat kritike ndaj vendimit të BQK-së.



11 <https://happyportal.com/ve...>
 12 <https://informer.rs/ve...>
 13 <https://pravda.rs/2024/1/28/open-balkan-genocid-pristina-i-tyrana-tuze-srbiju-za-genocid/>
 14 <https://nova.rs/kolumne/vucic-@ilum-kosovo/>

Në tekstet kritike¹⁴ për rolin pretenduar të Aleksandar Vuçiqit në rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës, u vërejtën edhe fjalë fyese që aludojnë në veprime seksuale. “Ai zhveshi pantallonat, mbylljuani sytë fëmijëve: Me eksploatimin e litiumit, Vuçiqi po e mbulon një temë tjetër të vështirë”, theksohet në titullin e një opinioni në NovaS. Në përgjithësi, në artikujt kritikë ndaj qeverisë së Serbisë, kjo temë u raportua si pjesë e një plani të dakorduar paraprakisht.



Gënjeshttrat rreth kushteve aktuale të jetesës në Rahovec u shpërndanë nga disa tabloidë në Serbi,¹⁵ gjë që çoi në një fushatë shpifjeje kundër gazetarëve të disa mediave në Serbi. Kurir, për shembull, pohoi se për të hyrë dhe dalë nga Hoça e Madhe, një fshat serb në Rahovec, duhet të kalohet përmes telit me gjemba dhe se forcat ndërkombëtare ruajnë qytetin.



¹⁴ <https://nova.rs/kolumne/vucic-ili-um-kosovo/>

¹⁵ <https://www.kurir.rs/vesti/politika/4340540/bez-casti-solakovi-cistunci-napali-dete-s-kim-zbog-patriotske-pesme-znaite-li-da-se-u-njen-orahovac-ulazi-kroz-bodljikavu-zicu/>

Ky raport është përgatitur nga Iniciativa e Re Sociale, një organizatë e shoqërisë civile nga Mitrovica e Veriut për të ndikuar përfundimisht në gjithëpërfshirjen, ndërtimin e besimit, proceset e demokratizimit dhe qeverisjen e mirë në Kosovë. Duke vepruar kështu, NSI ndjek vizionin e saj për një shoqëri gjithëpërfshirëse të ndërtuar mbi besimin dhe vlerësimin midis komuniteteve të saj, në të cilën qytetarët nga të gjitha grupet etnike marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe në qeverisjen e saj.